



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primljeno Më/Dana <u>05-08-2016</u> Viti			
Nr. i organit Org. broj	Numri/B:roj	Shtoiçë Prilog	Vlera Vendosje
	<u>01-013/995</u>		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, në bazë të Nenit 7, paragrafi 3, Nenit 10, paragrafi 1 pika 1.5 e Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës me Nr. të Protokollit 02-013/947, të datës 26.07.2016, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seance e mbajtur më datën 04.08.2016, aprovon këtë:

V E N D I M

(Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër, Pronën e Paluajtshme të Komunës, Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C për vendosjen e një trafo elektrike)

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, i jep në shfrytëzim afatshkurtër, prej 15 (pesëmbëdhjetë) viteve, pronën e paluajtshme të Komunës së Vitisë, Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C., Njësia në Viti, për vendosjen e një trafo elektrike në parcela me Nr.1300-2, me sipërfaqe prej 12m², në zonën kadastrale në Lubishtë.

Neni 2

Parcela kadastrale e sipërhënuar, që është objekt i këtij vendimi, i jepet në shfrytëzim afatshkurtër, pa të drejtën e dhënies me qira, pa të drejtën e nën kontraktimit me personat e tretë, me mundësi të vazhdimit vetëm për destinacionin e përcaktuar më lartë dhe nuk mund të shfrytëzohet për qëllime tjera.

Neni 3

Paluajtshmëria e cekur në Neni 1 të këtij vendimi, i jepet në shfrytëzim afatshkurtër, prej 15 (pesëmbëdhjetë) viteve, pa kompensim Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C., Njësia në Viti, për vendosjen e një trafo elektrike në parcela me Nr. 1300-2, me sipërfaqe prej 12m², në zonën kadastrale në Lubishtë.

Neni 4

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, obligohet të caktoj taksën ndaj kompanisë së lartcekur, bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba, me Nr.01-013/1356, të datës 30.09.2014.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për kadastër
2. Drejtorisë për Shërbime Publike,
3. Shërbimit të Kuvendit dhe
4. Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit:
Naïm Pira


